



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS



DEKLARATË E REKTORIT PROF. DR. MYNYR KONI PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Të nderuar kolegë dhe studentë të Universitetit të Tiranës, si dhe mbarë opinionit publik!

Dëshiroj t'ju bëj me dije se në përfundim të procesit të vlerësimit institucional që Universiteti i Tiranës ndërmoi në zbatim të ligjit të arsimit të lartë, por edhe në kuadër të rritjes së cilësisë, Bordi i Akreditimit, në datën 27.10.2018, akreditoi institucionalisht për 4 vjet Universitetin e Tiranës, duke nisur nga viti 2018 deri më 2022.

Në pritje të marrjes zyrtarisht të këtij vendimi nga Bordi i Akreditimit, ju bëj me dije se ky vlerësim, vjen pas një pune shumë të mirë të strukturave të UT-së, vlerësim ky i shprehur dhe në raportin e vlerësimit të jashtëm institucional nga ana e anëtarëve të Agjencisë Britanike të Akreditimit (QAA). Universiteti i Tiranës, standardet për katër fusha (*Organizimi dhe menaxhimi; Burimet njerëzore; Kurrikulat; Mbështetja e studentëve*) i ka përmbushur plotësisht (*fully met*), ndërsa në fushën e *Mësimdhënies* i ka përmbushur kryesisht (*substantially met*).

Në konkluzionet e raportit të vlerësimit të jashtëm, për të gjithë fushat e mësipërme, ekspertët dolën me këtë përfundim:

“Ekipi vlerësues i rekomandoi Bordit të Akreditimit se Universiteti i Tiranës i përmbush plotësisht (fully met) standardet e cilësisë”

Universiteti i Tiranës shpreh vlerësimin për gjithë ndërveprimin institucional me anëtarët e Agjencisë Britanike “Quality Assurance Agency” QAA dhe Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimitin e Lartë (ASCAL), gjatë gjithë procesit të akreditimit institucional.

Nëpërmjet këtij ndërveprimi korrekt dhe i realizuar në një frymë të plotë mirëkuptimi, Universiteti i Tiranës pati mundësinë të prezantojë progresin e arritur gjatë vitit të fundit në të pesë fushat e këtij vlerësimi institucional.